

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE

Financimi i përgjegjshëm gjinor për shoqëruesit e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë

Përgatitur nga *Ernera Dushica dhe Nicole Farnsworth për Rrjetin e Grave të Kosovës*



Hyrje

Personat me aftësi të kufizuara kanë shkallë më të lartë të papunësisë, të pasivitetit ekonomik si dhe të mungesës së mbështetjes sociale në krahasim me personat e tjerë.¹ Varësisht nga aftësia e kufizuar, disa prej tyre kanë nevojë për mbështetje nga një shoqërues çdo ditë, deri në 24 orë në ditë. Qeveria mund të mbështesin personat me aftësi të kufizuara përmes skemave të asistencës personale, duke mundësuar kështu rritjen e pjesëmarrjes së tyre në shoqëri. Edhe pse të dhënat zyrtare të ndara sipas gjinisë nuk kanë qenë gjithmonë të disponueshme, dihet se sipas roleve tradicionale gjinore, gratë historikisht kanë tendencë të kryejnë punë të kujdesit më shumë se burrat². Kështu, buxhetimi në mënyrë të duhur për ata që kryejnë punë të kujdesit ka implikime më të gjera për barazinë gjinore dhe veçanërisht mirëqenien ekonomike të grave, kjo me theks të veçantë në rastet kur puna e kujdesit nuk trajtohet si punë formale, siç është rasti në Kosovë.

Si organizatë anëtare e Rrjetit të Mbikëqyrësve të Buxhetit Gjinor (RrMBGj) në Ballkanin Perëndimor dhe në Republikën e Moldavisë, [Rrjeti i Grave të Kosovës \(RrGK\)](#) ka hartuar një analizë gjinore të kornizës ligjore që ka të bëjë me shoqëruesit në Kosovë dhe financimin e tyre nga qeveria për vitet 2019-2021. Vlerësim i ngjashëm është kryer në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Republikën e Moldavisë, duke përdorur një metodologji të përbashkët rajonale, të mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar.³ Të dhënat parësore janë mbledhur përmes kërkesave për të dhëna, intervistave dhe një fokus grupi me organizatat anëtare të RrGK-së të cilat punojnë me persona të ndryshëm me aftësi të kufizuara në mbarë Kosovën, kurse të dhënat dytësore janë mbledhur përmes rishikimit të kornizës ligjore të Kosovës, duke përfshirë edhe ligjet për ndarjet buxhetore.

¹ Kombet e Bashkuara, [Aftësia e Kufizuar dhe Punësimi](#). Departamenti i Çështjeve Ekonomike dhe Sociale: Aftësia e Kufizuar, 2007.

² Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), [Gratë dhe e ardhmja e Punës – Kujdesi për kujdestarët](#), 2015.

³ Metodologjia për këtë analizë u përgatit nga Keystone Moldova, një organizatë partnere e RrMBGj.

Të gjeturat kryesore dhe rekomandimet e paraqitura në këtë përmbledhje të politikave synojnë të informojnë dhe të plotësojnë diskutimet rreth proceseve të rëndësishme aktuale politike dhe ligjore, duke përfshirë Projektligjin për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara; Projektligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare; Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti; dhe Ligjet vjetore për Ndarjet Buxhetore në Republikën e Kosovës.

Praktikat Ndërkombëtare

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) është një traktat ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i ratifikuar nga OKB në vitin 2008. Në shkurt të vitit 2011, ky dokument u ratifikua nga 98 shtete palë si dhe nga Bashkimi Evropian (BE). Konventa pohon se të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të çasjes në të drejtat themelore të njeriut.⁴ Më konkretisht, skemat e asistencës personale parashikohen nga shumë konventa dhe traktate të njohura ndërkombëtarisht. Neni 19 i KDPAK-së shpjegon rëndësinë e shoqëruesëve për jetë të pavarur si dhe i detyron shtetet, “të sigurojnë çasje ndaj një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, shërbimesh rezidenciale dhe shërbimesh në komunitetet dhe të parandalojnë izolimin dhe veçimin e tyre nga komuniteti”.⁵ Shoqëruesit janë të domosdoshëm që personat me aftësi të kufizuara të ndihen pjesë e komuniteteve të tyre.

Për më tepër, Neni 6 i KDPAK së OKB-së njih pabarazitë dhe barrierat unike të shumta me të cilat mund të përballen gratë me aftësi të kufizuara dhe për këtë u bën thirrje shteteve të ofrojnë shërbime shtesë mbrojtëse:

1. Shtetet Palë pranojnë se gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuar janë objekt i një diskriminimi shumëformësh dhe për këtë do të marrin masa për tu siguruar se ato gëzojnë në mënyrë të plotë dhe të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
2. Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar zhvillimin, përparimin dhe fuqizimin e plotë të grave, me qëllim që tu garantohet ushtrimi dhe gëzimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në këtë Konventë⁶.

Sado që Kosova nuk është ende anëtare e BE-së, megjithatë ajo ka bërë zotime të qarta për anëtarësim në BE dhe kështu ka arsye të përpiqet drejt përmbyshjes së zotimeve nga BE-ja. Komisioni Evropian miratoi së fundmi Strategjinë Evropiane të Aftësisë së Kufizuar 2021-2030, e cila synon të fuqizojë individët me aftësi të kufizuara dhe të eliminojë barrierat.⁷ Për më tepër, në Planin e Veprimit Gjinor (GAP) III të Komisionit Evropian, një nga treguesit thotë: “adresimi i faktorit të ndërthurjes së gjinisë me format e tjera të diskriminimit”⁸. Ky tregues adreson diskriminimin ndërsektorial me të cilin mund të përballen gratë me aftësi të kufizuara. Shprehimisht, GAP III thotë: “Të drejtat e grave me aftësi të kufizuara duhet të jenë në qendër të strategjisë së ardhshme për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për vitet e ardhshme” 2021-2030.⁹

Në mënyrë që Kosova të përmbushë objektivat e anëtarësimit në BE, kuadri ligjor i Kosovës duhet të përputhet me përkufizimet e përcaktuara sipas KDPAK-së të OKB-së, në harmoni me angazhimet e Komisionit Evropian.

⁴ Organizata e Kombeve të Bashkuara, [Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara](#).

⁵ Ibid.

⁶ Ibid.

⁷ [Strategjia e BE-së për Aftësinë e Kufizuar 2021-2030](#).

⁸ Bashkimi Evropian, [Plani i Veprimit Gjinor III i BE-së](#): Një Agjendë Ambicioze për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave në Veprimin e Jashtëm të BE-së, 2020.

⁹ Ibid.

Korniza ligjore e Kosovës

Korniza ligjore e Kosovës nuk përfshin një përkufizim të qartë të aftësisë së kufizuar në përputhje me KDPAK-në e OKB-së. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për aftësimin, rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara e përkufizon aftësinë e kufizuar si një “kufizim në qasjen dhe aktivitetet e zakonshme në jetën e përditshme të një personi si rezultat i dëmtimeve fizike, shqisore, intelektuale ose mendore. parandaloni që ai/ajo të marrë pjesë në aktivitetet e jetës së përditshme”.¹⁰ Përkufizimi është i përqëndruar vetëm në në tri lloje të aftësisë së kufizuar, e kështu nuk përcakton lloje të tjera. Aftësitë e kufizuara psikologjike, autizmi dhe sindroma doën nuk përfshihen këtu në mënyrë të qartë. Përkufizimi i mjegullt i aftësisë së kufizuar shton paqartësitë që mund të pengojnë personat të kenë qasje në asistencën personale.

Ligji për Shërbimet Familjare dhe Sociale, i cili parashikon shërbime të drejtpërdrejta të kujdesit social, nuk përmban asnjë përkufizim të aftësisë së kufizuar. Kjo ngushton hapësirën se kush ka të drejtë për financim të asistentit personal. Ligjet e tanishme nuk ofrojnë ndonjë përkufizim apo dispozitë për gratë me aftësi të kufizuara dhe nuk e përfshijnë në mënyrë të duhur ndërsektorialitetin në ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Kështu, ligjet nuk janë në përputhje me synimet e KDPAK-së së OKB-së.

Asistenca personale nuk është e përcaktuar qartë në kornizën ligjore të Kosovës. Përkundrazi, Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare e përkufizon “Kujdesin e Drejtpërdrejtë Social” si “dhënien e ndihmës për detyrat shtëpiake, kujdesin personal, lëvizshmërinë, komunikimin ose mbikëqyrjen. Mund të sigurohet në shtëpinë e një personi, në një qendër ditore të specializuar ose në një shtëpi banimi”¹¹. Sipas këtij ligji, personi në nevojë është edhe “person” në territorin e Kosovës, pavarësisht nga statusi apo vendlindja, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak të sëmundjes fizike apo paaftësisë.¹² Procesi i aplikimit për kujdes të drejtpërdrejtë social nuk është i detajuar në ligj, por duket se Qendra për Punë Sociale (QPS) në secilën komunë është përgjegjëse për identifikimin e personave të cilët kanë të drejtë për të marrë kujdes social dhe për koordinimin e kujdesit social. Sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, QPS-të në secilën komunë janë përgjegjëse për mbajtjen e listës së atyre që kanë nevojë për shërbime sociale:

Qendrat për Punë Sociale me pëlqimin e individëve në fjalë do të mbajnë një regjistër të personave që kanë nevojë për shërbime sociale, të cilët janë rezidentë në territorin e tyre dhe të cilëve u mungon mbështetja familjare ose e komunitetit dhe që kanë vështirësi të mbajnë veten, ose janë në rrezik të vetë- neglizhencë, shfrytëzimit ose abuzimit nga të tjerët ose çdo formë tjetër dëmtimi. Qendra për Punë Sociale do të aranzhojë që personat në nevojë që janë në këtë regjistër të vizitohen rregullisht nga një person përgjegjës, me qëllim monitorimin e sigurisë dhe mirëqenies së tyre¹³.

Qeveria është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së shërbimeve të drejtpërdrejta të kujdesit social nën Shërbimet Sociale dhe Familjare, të cilat rregullohen nga Departamenti i Mirëqenies Sociale. Përderisa ky departament ishte i vendosur në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), për shkak të riorganizimit të qeverisë në vitin 2021, departamenti tash është në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Ligji për politikën sociale dhe familjare ka krijuar një këshill që është përgjegjës për ruajtjen e standardeve dhe disiplinës profesionale në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare. Këshilli vepron si autoriteti licencues dhe regjistruer i profesionistëve që punojnë në këtë fushë.¹⁴ Sipas nenit 5.3 të këtij ligji, Këshilli është përgjegjës për:

¹⁰ [Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.](#)

¹¹ [Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.](#)

¹² Ibid, Neni 1.3, e.6.

¹³ Ibid, neni 7 “Roli i Qendrave për Punë Sociale”.

¹⁴ Ibid, Neni 5.2.

Mbajtjen e regjistrit të profesionistëve të Shërbimeve Sociale dhe Familjare të cilët janë të licencuar për të ushtruar profesionin në Kosovë. Ai ka autoritetin për të vendosur se kush mund të mbajë një licencë dhe kush mund të mbajë një licencë si specialist i Shërbimeve Sociale dhe Familjare. Ai përcakton se çfarë zhvillimi të vazhdueshëm profesional kërkohet nga profesionistët e Shërbimeve Sociale dhe Familjare¹⁵.

Pra, profesionistët që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta sociale duhet të licencohen dhe të regjistrohen nga ky departament. Profesionistët që punojnë në komuna si dhe në organizata joqeveritare (OJQ) mund të ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta të kujdesit social. Megjithatë, deri më sot, as ligji e as aktet nënligjore nuk e kanë specifikuar ekspertizën minimale dhe kërkesat profesionale që duhet të kenë asistentët personalë për t'u licencuar dhe për të ofruar këto shërbime.

Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare gjithashtu përcakton detyrimet e komunës në mbikëqyrjen e shërbimeve sociale, zakonisht përmes drejtorisë përkatëse brenda secilës komunë: "Drejtoritë ofrojnë shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre përmes aktiviteteve të Qendrave për Punë Sociale ose duke siguruar financa. ose ndihmë të tjera për OJQ-të për t'u mundësuar atyre ta bëjnë këtë".¹⁶ Drejtoria brenda komunës është përgjegjëse për të siguruar që QPS-të ose OJQ-të ofrojnë kujdes të drejtpërdrejtë personal për të gjithë ata që kanë të drejtë. Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare përfshin një dispozitë lidhur me rëndësinë e OJQ-ve në ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale; OJQ-të mund të ofrojnë shërbime sociale për grupet më të ndjeshme përmes një kontrate me Komunën ose përmes nismave të tyre.¹⁷ Për të ofruar këto shërbime, këto OJQ duhet së pari të licencohen nga Departamenti i Mirëqenies Sociale dhe t'u përmbahen të gjitha rregulloreve, direktivave dhe procedurave në lidhje me aktivitetet e tyre të përcaktuara nga Ministria.¹⁸ Deri më sot, nuk ekzistojnë kritere specifike minimale për OJQ-të ose anëtarët e stafit të tyre që ofrojnë asistentë personalë.

Dy ligje kyçe që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara dhe asistentët personalë janë aktualisht në shqyrtim për ndryshim, Projektligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare; dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti. Ndërkohë, së shpejti për konsultim publik do të jetë edhe Projektligji i ri për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara. Përfaqësuesit e MFPT parashohin se ndryshimet ligjore dhe aktet nënligjore që do të pasojnë do të vendosin përkufizime më të qarta, më gjithëpërfshirëse në lidhje me cilët persona me aftësi të kufizuara do të kualifikohen për asistentë profesionistë dhe kualifikimet minimale që do të duhet të plotësojnë asistentët personalë për t'u licencuar.¹⁹ Në të vërtetë, qartësimi i përkufizimeve ligjore, sigurimi i qasjes për persona të ndryshëm me aftësi të kufizuara bazuar në nevojat e tyre dhe vendosja e kualifikimeve minimale të qarta brenda kuadrit ligjor për asistentët personalë do të jenë të gjitha thelbësore për sigurimin e shërbimeve cilësore për ta në të ardhmen.

[Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#) gjithashtu njeq nevojat e ndryshme të grave me aftësi të kufizuara si dhe punën e kujdesit të kryer nga gratë për personat me aftësi të kufizuara. Një nga aktivitetet e saj drejt rritjes së punësimit të grave dhe vajzave është "sigurimi i qasjes në shërbime cilësore sociale dhe familjare, qendra rezidenciale për kujdesin ditor për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara"²⁰. Megjithatë, edhe pse synon përmirësimin e qasjes së grave me aftësi të kufizuara në fuqinë punëtore, ky program nuk u referohet në mënyrë të qartë asistentëve personalë. As Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës nuk i përmend asistentët personalë²¹.

Sipas Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ, Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që të bëhet Vlerësimi i Ndikimit në Barazi Gjinore për të informuar të gjitha projektligjet.²² Ky vlerësim është i

¹⁵ Ibid, neni 5.3.

¹⁶ Ibid, neni 6.

¹⁷ Ibid, neni 8.

¹⁸ Ibid, neni 8.3.

¹⁹ Intervistë e RrGK me zyrtarë të MFPT, prill 2022.

²⁰ Agjencia për Barazi Gjinore, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024.

²¹ Zyra për Qeverisje më të mirë, [Strategjia Nacionale mbi të Drejtat për Personat me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës](#) 2013-2023.

²² Qeveria e Kosovës, [Strategjia për Rregullim më të mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021](#).

rëndësishëm për identifikimin e mënyrave në të cilat një ligj mund të ndikojë ndryshe gratë e ndryshe burrat, në mënyrë që të informojë e të plotësojë hartimin e një ligji që do të kontribuonte në përparimin e barazisë gjinore. Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës ka dhënë udhëzime të qarta lidhur me atë se çfarë duhet të përmbajë ky vlerësim.²³ Megjithatë, Qeveria e Kosovës duket se ende nuk e ka bërë këtë vlerësim, për të informuar projektligjet e lartpërmendura, gjë që është e nevojshme para finalizimit të ligjeve.²⁴

Përdoruesit e Asistencës Personale

Kosova nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e përgjithshëm të personave me aftësi të kufizuara, kjo pasi jo të gjithë janë të regjistruar. Megjithatë, bazuar në vlerësimet, më shumë se 200,000 persona me aftësi të kufizuara jetojnë në Kosovë, apo afërsisht 10% e popullsisë²⁵.

Dy kategori kryesore të personave me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të aplikojnë për asistentë personalë: përfituesit paraplegjikë dhe tetraplegjikë (PTTP) dhe personat e verbër. Të dyja këto kategori ndahen më tej në dy grupe. Grupi 1 i PTTP përfshin persona me një shkallë paaftësie 80% ose më shumë dhe Grupi 2 përfshin persona me një shkallë paaftësie më të ulët se 80%, bazuar në raport mjekësor. Ndërsa, në grupin 1 për kategorinë e të verbërve përfshihen ata me shikim 0 deri në 0,2 dhe në grupin 2 me shikim mbi 0,2, prap bazuar në raport mjekësor. Të dy grupet nga të dyja kategoritë marrin pension invaliditeti nga qeveria. Megjithatë, vetëm përfituesit e Grupit 1 nga çdo kategori kanë të drejtë për asistentë personalë.

Personat që kanë nevojë për asistentë personalë fillimisht duhet të aplikojnë për pensione brenda komunave të tyre. Komiteti Shëndetësor i përbërë nga ekspertë shëndetësorë dhe përfaqësues të MFPT-së shqyrton këto aplikime. Divizioni i MFPT-së për pensione është përgjegjës për shpërndarjen e pensioneve të aftësisë së kufizuar si për ata që kualifikohen për asistentë personalë, e po ashtu edhe për ata që nuk kualifikohen. Bazuar në raportet mjekësore, divizioni vendos nëse përfituesit e Grupit 1 nga kategoritë e sipërpërmendura kualifikohen për asistentë personalë. Pensioni për personat PTTP pa asistentë personalë është 150€ në muaj dhe 375€ gjithsej për ata që kërkojnë asistentë personalë, duke parashikuar që personat me aftësi të kufizuara të marrin 225 € dhe asistentët e tyre personal 150€ në muaj. Personat e verbër marrin 125€ në muaj dhe 250€ nëse kërkojnë një asistent personal, duke sugjeruar një kompensim prej 125€ për asistentin personal në muaj. Qeveria shpërndan çdo muaj shumën e plotë të pensionit dhe kompensimit për asistentin personal të personit me aftësi të kufizuar të regjistruar, të kualifikuar. Kështu, asistentët personalë nuk marrin asnjë pagesë direkte nga qeveria. Personi me aftësi të kufizuar është përgjegjës për zgjedhjen e asistentit të tij personal, pavarësisht nëse personi është anëtar i familjes apo jo.

Në Kosovë në vitin 2019, gjithsej 3,831 persona me aftësi të kufizuara ishin të regjistruar që kishin asistentë personalë, kurse në vitin 2020 ky numër ishte 3,629, si dhe në vitin 2021 ky numër ishte 3,499 (shih Tabelën 1). Vazhdimisht, gratë kanë përbërë afërsisht 45% të përdoruesve të asistentëve personalë, ndërsa burrat kanë përbërë 55%.

Tabela 1. Totali i Përfituesve me Shoqërues, 2019-2021

	PTTP	Të verbër	# dhe % e personave me shoqërues, sipas gjinisë				
			Gra	%	Burra	%	Gjithsej
2019	2,238	1,593	1,717	44.8%	2,114	55.2%	3,831
2020	2,161	1,468	1,619	44.6%	2,010	55.4%	3,629
2021	2,108	1,391	1,576	45%	1,923	55%	3,499

Disa persona që mund të kenë nevojë për asistentë personalë, si ata me aftësi të kufizuara mendore, paaftësi të tjera fizike ose të shurdhër nuk përmenden në mënyrë të qartë në kuadrin ligjor si

²³ Agjencia për Barazi Gjinore, Manuali për Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë Gjinore.

²⁴ Intervistat e RrGK-së me zyrtarë të MFPT, prill 2022.

²⁵ Intervistë e RrGK-së me Divizionin e Pensioneve, MFPT.

të kualifikuar. Kuadri ligjor nuk parashikon qartë që ata të marrin pension invaliditeti apo asistent personal, mirëpo ata mund të aplikojnë nëse kanë një paaftësi prej të paktën 80%.

Shoqëruesit

Personat me aftësi të kufizuara zgjedhin asistentët e tyre personalë. Asistenti personal mund të jetë një anëtar i familjes ose dikush i referuar nga QPS-ja. Pavarësisht kësaj, secili që shërben si asistent personal duhet të kontraktohet nga personi me aftësi të kufizuara. Kontraktimi bëhet përmes një noterie dhe qeveria nuk është e angazhuar në këtë proces. Kështu, qeveria nuk punëson askënd për të shërbyer si asistent personal. As nuk cakton asistentë personalë, megjithëse QPS-ja mund të bëjë referime.

Siç u përmend, kuadri ligjor i tanishëm nuk kërkon që asistentët personalë të kenë ndonjë kualifikim specifik për të kryer këtë punë; kushdo mund të bëhet asistent personal. Është e rëndësishme që personat me aftësi të kufizuara të kenë të drejtën të zgjedhin asistentët e tyre në mënyrë që të ndihen rehat me ata persona. Ndërkohë, në disa situata, asistentët personalë thuhet se nuk kanë pasur kualifikime të mjaftueshme për këtë punë, gjë që ka sjellë lëndime fizike, djegie dhe sfida të tjera.²⁶

Në varësi të nivelit të aftësisë së kufizuar, disa persona me aftësi të kufizuara kërkojnë ndihmë personale vetëm për disa orë gjatë ditës, ndërsa të tjerë kërkojnë kujdes 24-orësh. Veçanërisht, kompensimi i dhënë për asistentët personal është i njëjtë pavarësisht nga numri i orëve që ata punojnë ose që ata duhet të jenë në dispozicion për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara. Fakti që shoqëruesit nuk trajtohen formalisht si punonjës, lë mundësi të shumta shkeljesh të të drejtave të tyre të punës, duke përfshirë punën jashtë orarit. Për më tepër, shumica që marrin asistentët personalë nuk mbulon shpenzimet e tyre bazë. Në të vërtetë, kompensimi është më i vogël se paga minimale në Kosovë (170€) dhe puna e tyre përkujdesëse nuk njihet zyrtarisht si punë. Duke qenë se kjo punë nuk trajtohet si punë, asistentët personalë nuk marrin asnjë kontribut pensioni. Kjo mund të shtojë potencialisht varfërinë e tyre përgjatë jetës, veçanërisht nëse ata nuk janë në gjendje të kryejnë punë të tjera sepse ofrojnë kujdes me orar të plotë. Ky kompensim i ulët dhe kushtet e këqija të punës për asistentët personalë shtojnë vështirësitë për të gjetur persona të gatshëm të sakrifikojnë kohën, shëndetin fizik dhe mirëqenien e tyre financiare për të ofruar këto shërbime.²⁷ Mosnjohja e punës së shoqëruesëve si punë formale vetëm se rritë shkallën edhe ashtu jashtëzakonisht të ulët të punësimit të grave në Kosovë (vetëm dy në dhjetë gra janë të punësuara në sektorin formal)²⁸; si dhe thëllon pabarazitë gjinore, veçanërisht pozitën relativisht më të dobët ekonomike të grave brenda familjes dhe shoqërisë. Edhe në këtë rast, puna joformale e asistentëve personale mund të shtojë varfërinë e grave pensioniste, pasi ato nuk kanë të paguara kontribute për kursime pensione.

Transformimi i punës aktualisht joformale të shoqëruesëve në punë formale mund të kontribuojë drejtpërdrejt në zbatimin e zotimeve të qeverisë për të luftuar ekonominë joformale. Për më tepër, kjo gjë do të adresonte edhe rekomandimet e bëra në Raportin e BE-së për Kosovën lidhur me adresimin e joformalitetit, rritjen e punësimit, mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe fuqizimin e e mëtejshëm të barazisë gjinore²⁹. Më e rëndësishmja, duke ofruar kujdes më cilësor, kjo mund të lehtësonte "pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët" për personat me aftësi të kufizuara në përputhje me KDPAK.

RrGK kërkoi të dhëna nga MFPT për numrin e grave dhe burrave të angazhuar si shoqërues, mirëpo këto të dhëna nuk na u ofruan. MFPT mund të mos i ketë këto të dhëna sepse personi me aftësi të kufizuara merr pagesën dhe më pas paguan drejtpërdrejt asistentin personal të kontraktuar; e kështu fondet nuk transferohen nga vet MFPT-ja. Duke marrë parasysh normat tradicionale gjinore dhe rolin e tyre si kujdestare, gratë duken më të prirura për të shërbyer si asistente personale, sesa burrat.³⁰ Shpesh anëtarët e familjes, duke përfshirë nënat dhe motrat, kujdesen për personat me aftësi të kufizuara.

²⁶ Fokus grupi i RrGK me OShC që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, prill 2022.

²⁷ Ibid.

²⁸ Agjencia e Statistikave e Kosovës, [Anketa e Fuqisë Punëtore \(AFP\)](#), TMI 2021.

²⁹ Komisioni Evropian, [Raporti i Kosovës 2021](#), faqe 6, 28, 51, 85, 95.

³⁰ Ibid.

Financimi i Asistencës Personale

Pjesërisht për shkak të faktit se Kosova nuk përdor buxhetimin programatik, Kosova nuk ka një linjë të veçantë buxhetore për asistentët personalë apo shërbimet përkatëse. Pensionet për personat me aftësi të kufizuara dhe asistentët e tyre personal janë buxhetuar nga Divizioni i Pensioneve MFPT. Linjat kryesore buxhetore për këtë janë linja buxhetore “Pensionet për aftësinë e kufizuar”, vija buxhetore “Kompensimi për të verbërit” dhe vija buxhetore “Paraplegjikët dhe tetraplegjikët”. Shumat e alokuara për këto linja buxhetore janë paraqitur në tabelën 2. Të gjitha këto janë të buxhetuara në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere.

Tabela 2. Buxheti i ndarë për pensionet për aftësinë e kufizuar, kompensimin për të verbërit dhe paraplegjikët dhe tetraplegjikët

Viti	Pensionet për aftësinë e kufizuar	Kompensimet për të Verbërit	Paraplegjikët dhe tetraplegjikët
2019	17,100,000	5,500,000	12,401,000
2020	17,100,000	5,500,000	12,401,000
2021	17,650,000	5,400,000	11,000,000

Tabela 3 ilustron numrin e përfituesve të pensioneve të aftësisë së kufizuar që kanë pasur asistentë personalë në vitet 2019 – 2021 sipas gjinive të personave me aftësi të kufizuar. Përderisa shuma e dhënë për asistentët personalë mund të llogaritet, megjithatë ajo nuk mund të ndahet sipas gjinisë për shkak të mungesës së informacioneve.

Tabela 3. Kompensimi i përfituesve të pensionit të aftësisë së kufizuar me shoqërues sipas gjinisë ³¹

Viti	PPTP						Të Verbër					
	Gra			Burra			Gra			Burra		
	#	Shuma	%	#	Shuma	%	#	Shuma	%	#	Shuma	%
2019	1006	€383,125	45.1	1232	€465,625	54.9	711	€188,310	43.8	882	€241,532	56.2
2020	970	€363,720	44.9	1191	€445,875	55.1	649	€160,375	44.1	819	€202,850	55.9
2021	955	€370,275	46	1153	€434,595	54	621	€159,050	43.9	770	€202,925	56.1

Meqenëse burrat përbëjnë shumicën e përfituesve të pensionit, ata vazhdimisht kanë marrë një përqindje më të lartë të buxhetit se sa gratë. Duke qenë se nuk është kryer një analizë e plotë gjinore, është e vështirë të dihen arsytet pse më shumë burra se gra përfitojnë nga këto transferime. Potencialisht më shumë burra se gra kanë aftësi të kufizuara, ose ndoshta gratë me aftësi të kufizuara kanë më pak çasje në këto shërbime. Vetëm një analizë e thellë gjinore mund të qartësojë nivelin e nevojës për shërbime të tilla mes grave dhe burrave.

Pa dyshim, asistentët personalë duhet të kompensohen të paktën me pagën minimale dhe në bazë të orëve të kërkuara për punën e tyre të përkujdesjes, të përcaktuar gjatë procesit të aplikimit në përputhje me nevojat e personit me aftësi të kufizuara, e jo në bazë të tarifës fikse universale. Duke pasur parasysh kualifikimet që duhet të kenë asistentët personalë për këtë punë, do të ishte më e përshtatshme që asistentët personalë të paguheshin në përputhje me pagën mesatare. *Tabela 4* vlerëson kostot që do të lidheshin me financimin më të përshtatshëm të asistentëve personalë nga qeveria, kjo bazuar në numrin e përfituesve në vitin 2021 të paraqitur në *tabelën 1*. Nëse Qeveria rritë pagesën për shoqëruesit për të përputhur me pagën minimale aktuale, kostoja totale e vlerësuar do të ishte afërsisht 7,137,960€ në vit. Kjo do të rriste buxhetin e ndarë për këtë skemë duhet të rritet për së paku 1,257,060€ në krahasim me atë që supozohet se është planifikuar për shoqëruesit përmes linjave aktuale të buxhetit.

Tabela 4. Kostot e vlerësuara për financimin e nevojshëm të shoqëruesëve nga Qeveria.

	Kostoja e parashikuar për person				Kostoja e parashikuar gjithsej				PTTP + Të verbër Për Vit
	PTTP		Të verbër		PTTP		Të verbër		
	Për muaj	Për vit	Për muaj	Për vit	Për muaj	Për vit	Për muaj	Për vit	

³¹ Të dhënat zyrtare nga Divizioni i Pensioneve MFPT.

Norma aktuale e pagës	€150	€1,800	€125	€1,500	€316,200	€3,794,400	€173,875	€2,086,500	€5,880,900
Paga minimale aktuale	€170	€2,040	€170	€2,040	€358,360	€4,300,320	€236,470	€2,837,640	€7,137,960
Paga minimale e planifikuar	€250	€3,000	€250	€3,000	€527,000	€6,324,000	€347,750	€4,173,000	€10,497,000
Paga mesatare bruto	€484	€5,808	€484	€5,808	€1,020,272	€12,243,264	€673,244	€8,078,923	€20,322,187

Megjithatë, për të kuptuar më mirë kostot e mundshme kërkohet analizë e mëtejshme gjinore. Disa persona me aftësi të kufizuara mund të kërkojnë vetëm asistencë personale me kohë të pjesshme, duke ulur në këtë mënyrë kompensimin për ata që nuk ofrojnë tetë orë kujdes. Ndërkaq, disa persona me aftësi të kufizuara kërkojnë kujdes 24-orësh, gjë që do të kërkonte deri në tre asistentë personalë për person për të mbrojtur të drejtat e punës së kujdestarëve. Personat me aftësi të kufizuara të tjera që janë lënë jashtë këtyre skemave, por që meritojnë trajtim të barabartë, si personat e shurdhër ose me aftësi të kufizuara mendore, duhet gjithashtu të merren parasysh për të arritur në vlerësime të sakta buxhetore. Pas analizave të mëtejshme gjinore, duke përfshirë nevojat për vlerësim, qeveria do të duhet të rregullojë buxhetin.

Rekomandime

- Të ndryshohen ligjet ekzistuese si Ligji Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligji Nr. 2003/23 për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar, Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe Ligjet vjetore për Ndarjet Buxhetore për Republikën e Kosovës (çdo vit), në mënyrë që ato të përfshijnë përkufizime të qëndrueshme të njohura ndërkombëtarisht të aftësisë së kufizuar. Të sigurohet që këto ligje të përdorin një qasje të ndërthurjes ndaj gjinisë, duke marrë parasysh nevojat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave me aftësi të kufizuara, si dhe ndërthurjen me përkatësinë etnike, moshën dhe faktorë të tjerë që mund të pengojnë çasjen në shërbimet e duhura të kujdesit.
- Para se të ndryshohen ligjet ekzistuese dhe të miratohen projektligjet e ardhshme, të sigurohet që është bërë Vlerësimi i Ndikimit Gjinator si pjesë e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ i cili kërkohet sipas Strategjisë 2. 0 për Rregullim më të Mirë për Kosovën. Të merret parasysh numri i orëve të kujdesit që i nevojiten një personi me aftësi të kufizuar për asistencë personale, në mënyrë që të vlerësohen më mirë implikimet buxhetore të kompensimit të të drejtave të tyre të punës. Të shqyrtohen arsyet kryesore se përse burrat kanë tendencë të përdorin asistencë personale më shumë se gratë, duke identifikuar çdo sfidë të mundshme me të cilën gratë mund të përballen në çasjen e këtyre shërbimeve.
- Të rishikohen kriteret e përshtatshmërisë për asistencën personale, pasi shumë më tepër persona mund të kenë nevojë për asistencë personale sesa ata që e marrin atë aktualisht, duke pasur parasysh se personat me aftësi të kufizuara që arrijnë në më shumë se 50% mund të kërkojnë që asistentët personalë të marrin pjesë aktive në shoqëri.
- Pas miratimit të ligjeve, të specifikohet në legjislacionin dytësor përvoja minimale, ekspertiza dhe kualifikimet që duhet të kenë shoqëruesit për të ofruar shërbime të kualifikuara, të tilla si trajnimi i detyrueshëm dhe testimi i kualifikimit. Të organizohen vazhdimisht aktivitete për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve për shoqërues. Personat duhet të zgjidhen prapë nga personat me aftësi të kufizuara dhe në marrëveshje me ta.
- Të krijohet një linjë buxhetore specifike dhe e përhershme për financimin e Skemës së Asistencës Personale, e ndarë për shoqëruesit që çertifikohen si asistentë. Në ndërkohë, të rritet shuma e buxhetuar për asistent personal, e cila aktualisht është 150€ për shoqërues të personave PTPP dhe 125€ për personat e verbër, për të përputhur të paktën me pagën minimale (aktualisht 170€). dhe idealisht paga mesatare neto (432€). Në vitin 2023, buxheti i vlerësuar do të ishte afërsisht 7,137,960€, duke mos përfshirë kategoritë e tjera që kanë nevojë për asistencë personale, por që nuk e marrin atë aktualisht. Të planifikohet për inflacion të mundshëm.
- Përderisa personat me aftësi të kufizuara mund të vazhdojnë të ndajnë pagesat për të minimizuar kostot e transfertave, qeveria mund të mbajë automatikisht kontributin e pensionit prej 10% dhe ta vendosë atë në fondin e pensionit të shoqëruesit të regjistruar, duke parandaluar varfërinë më vonë në jetë.

- Për të mbuluar kostot shtesë të shoqëruesëve, merrni parasysh përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave përkatëse, të tilla si zbatimi i gjobave të rritura për bizneset që nuk sigurojnë vendndodhje fizike dhe shërbime të çashme në përputhje me ligjet; ata që nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuara sipas ligjit³²; dhe ata që konstatohet se kanë diskriminuar personat me aftësi të kufizuara ose kanë shkelur të drejtat e tyre. Konsideroni gjithashtu vendosjen e taksave për produktet luksoze, siç janë makinat luksoze, sipas rekomandimeve të RrGK-së³³.
- Gjatë gjithë procesit të hartimit të këtyre ligjeve, duke përfshirë buxhetet dhe legjislacionin dytësor, të sigurohen konsultime domethënëse gjithëpërfshirëse me organizatat e të drejtave të grave që punojnë me gra dhe burra me aftësi të kufizuara, në drejtim të identifikimit të problemeve dhe adresimit të tyre përmes kuadrit ligjor.

³² Ligji Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara thotë se për çdo 50 të punësuar, duhet të punësohet një person me aftësi të kufizuar.

³³ RrGK, [Taksimi i përgjegjshëm gjinor: Heqja e taksave për produktet esenciale të higjienës menstruale](#), maj 2022.